



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Zgjatje e Afatit për Aplikim deri me datën 26.01.2018
Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve
vlerësuese për vlerësimin e Projekt propozimeve të OJQ-ve

Zyra e Kryeministrit, gjatë vitit 2018 planifikon që përmes thirrjeve publike të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të organizatave Jo-Qeveritare në fushat prioritetet që ndërlidhen me: qeverisjen e mirë, të drejtat e njeriut, kundër diskriminimi, të drejtat e komuniteteve, barazia gjinore, personat e zhdukur, të drejtat gjuhësore, etj

Rregullorja MF- Nr- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësueses për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve. Për këtë qëllim, Zyra e Kryeministrit, fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së institucionit do të caktohen në cilësinë e anëtarëve në komisione vlerësuese për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor.
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;

- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: trendeline.dreshaj@rks-gov.net deri me datën 26.01.2018. Aplikimin mund ta bëni po ashtu, duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në zyrën Nr. 607, Ndërtesa e Qeverisë, Kati 6, Sheshi Nëna Terezë, Prishtinë. Zyra e Kryeministrit, do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike do të bëhen pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm të cilët do të ftohen sipas nevojës për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese sipas thirrjeve publike që do të bëjë secila zyrë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit gjatë vitit 2018.

Sinqerisht,

Habit Hajredini